

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6503  
E enjte, 6 janar 2022  
çmimi 0.40 €

Haradinaj: Majtismi ekstrem po e dërgon Kurtin në luftë kundër aleatëve | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de


KËRKOHEM QË DIPLOMACIA E KOSOVËS TË KALOJË NË OFENSIVË PËR NJOHJE TË REJA | FAQE 4-5

## QEVERIA TË ANGAZHONET PËR NJOHJEN EDHE NGA PESË VENDET E BE-së



Njohësit e politikës së jashtme u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës që gjatë këtij viti të angazhohen për njohjen edhe nga pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Edita Tahiri dhe Avdi Smajlaj kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës duhet të krijojë strategji dhe grupe lobuese në kryeqendrat e Spanjës, Rumanisë, Sllovakisë, Qipros dhe Greqisë. Sipas tyre, gjatë këtyre muajve kjo ministri nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet për fitim të këtyre njohjeve

### AKTUALE



BORRELLI E PARALAJMËRON RUSINË PËR PASOJA NËSE E PROVOKON UKRAINËN | F. 2

POLICIA VAZHDON AKTIVITETIN PËR ZBATIMIN E MASAVE KUNDËR COVIDIT | F. 7

KRYETARI I SKENDERAJT ÇAKTON DITËN E MËRKURË TAKIM ME QYTETARËT | F. 6

### EKONOMI



OPOZITA KËRKON RITJEN E PAGËS MINIMALE, SINDIKATA KËRKON TË MOS JETË NËN 400 EURO | F. 8

MEDIET BOTËRORE SHKRUAJNË PËR NDALIMIN E PRODHIMIT TË KRIPTOVALUTAVE NË KOSOVË | F. 8

### SPORT



BALLKANI PARAQET ILIR DAJËN | F. 10

LDK-ja dhe PDK-ja arrijnë marrëveshje për bashkëqeverisje në Prishtinë | FAQE 3



KURTI DHE LATIFI U BËJNË THIRRJE QYTETARËVE TË VAKSINOHEN KUNDËR COVIDIT | FAQE 3

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Orce Kamçev lirohet nga paraburgimi pas garancisë prej 11 milionë eurosh

SHKUP, 5 JANAR - Jordan "Orce" Kamçev, një nga emrat më të përfolur në Maqedoninë e Veriut, është liruar nga paraburgimi me një garanci bankare prej 11 milionë eurosh. Vendimin për lirimin e Kamçevit, bashkëpronar i spitalit privat "Sistina" në Shkup, por edhe i shumë bizneseve të tjera, e mori Gjykata e Apelit të martën në mbrëmje, pasi e ka vlerësuar të mjaftueshëm shumën e ofruar si garanci për të mos u arratisur.

Orce Kamçev është familjar i ish-drejtorit të policisë sekrete, Sasho Mijallkov, i cili para Vitit të Ri po ashtu u lirua nga paraburgimi me garanci bankare prej gati 11 milionë eurosh.

Kamçev, sikur edhe Mijallkov, akuzohen për veprën penale "Parcelat në Vodno", blerje të paligjshme të tokës për ndërtim. I akuzuari i parë në këtë rast është ish-kryeministri maqedonas Nikolla Gruevski, i

cili ndiqet penalisht për përvetësim të 1.3 milion eurove nga donacionet partiake të përdorura për blerjen e parcelave në Vodno, zonë turistike malore në Shkup.

Orce Kamçev që nga 31 dhjetori ndodhet për trajtim mjekësor në spitalin "Sistina" për shkak të ankesave shëndetësore. Ai ndodhet në paraburgim që nga marsi i vitit 2021, kur u arrestua lidhur me dyshimet se mund të arratiset.

Vendimi i Gjykatës së Apelit e detyron Kamçevin që të paraqitet rregullisht në gjykatë për të dëshmuar praninë e tij në Shkup ndërsa i janë konfiskuar edhe dokumentet e udhëtimit.

Biznesmeni i afërt me Gruevskin është i dyshuar edhe në një proces tjetër gjyqësor të koduar si "Perandoria", ku hetohet për krim financiar, konkretisht për pastrim parash përmes kompanive në Maqedoni të Veriut dhe kompanive të regjistruara në vende të huaja.




Kamçev është drejtor i kompanisë "Orka Holding", themeluar që nga viti 1990 nga babai i tij. Vendimi për lirimin e Kamçevit dhe vendimi tjetër për lirimin e Sasho Mijallkovit ka nxitur reagime të shumta në opinion, duke e akuzuar gjyqësorin për lidhje me

pushtetin e kaluar, por edhe korrupsion. "Gjykatësit që morën vendimin duhet t'i japin llogari opinionit se në çfarë baze kanë marrë një vendim të tillë dhe në cilën formë do ta marrin përgjegjësinë në rast se Mijallkov arratiset", thuhej në reagimin e

ministrit të Drejtësisë, Bojan Mariçiq.

Ndërsa Aleanca për Shqiptarët akuzoi gjyqësorin për standarde të dyfishta pasi, sipas opozitës shqiptare, mbeten të pazbardhura të gjitha rastet ku janë të dënuar shqiptarët.

## Borrelli e paralajmëron Rusinë për pasoja nëse e provokon Ukrainën



BRUKSEL, 5 JANAR - Çfarëdo provokimi apo agresioni kundër Ukrainës do të kishte pasoja serioze, ka thënë shefi i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme, Josep Borrell. Ai e ka bërë këtë mesazh për Moskën para se të zhvillojë takime me zyrtarë të Ukrainës më 5 janar. "Bashkimi Evropian është partneri më i afërt i Ukrainës dhe ne e mbështetim plotësisht integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës", ka thënë diplomati i BE-së në një intervistë për agjencinë polake të

lajmeve, PAP.

Përgjatë vizitës së tij, Borrell do të takohet me zyrtarë të Ukrainës, përfshirë ministrin e Jashtëm, Dmytro Kuleba në Kiev. Vizita e Borrellit është pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare për t'i ulur tensionet në kufirin ukrainas. Për disa javë Perëndimi është shqetësuar për raportimet se Rusia ka angazhuar dhjetëra mijëra ushtarë në zonat jo fort larg Ukrainës, duke nxitur frikë për pushtim rus. Rusia hedh poshtë këto supozime dhe akuzon

Ukrainën se ka dërguar më shumë ushtarë në zonat lindore të cilat kontrollohen nga separatistët pro-rusë.

Këto zhvillime kujtojnë ngjarjet e vitit 2014, kur Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë dhe ka nisur t'i mbështesë separatistët në lindje të Ukrainës. Bisedimet në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë do të mbahen javën tjetër në Gjenevë. Rusia dhe NATO-ja, po ashtu, kanë planifikuar takime të ndara më 12 janar.

## Artistët e tatuazheve ankohen për ndalesën e re të BE-së

BRUKSEL, 5 JANAR - Artistët e tatuazheve kanë thënë se një ndalesë e re e Bashkimit Evropian për mijëra kemikate që përdoren në ngjyra mund ta dëmtojë industrinë e tyre. Kufizimet, të cilat janë miratuar të martën, zbatohen për substanca që mund të shkaktojnë kancer apo probleme të tjera shëndetësore dhe që kryesisht lidhen me ngjyrat. Bashkimi Evropian ka përditësuar rregulloren për kemikate e cila është miratuar fillimisht më 2020.

Ndalesa përfshin 4 000 kemikate, disa prej të cilave përdoren për tatuazhe, por zëvendësimet e tyre janë nëpër tregje. Sipas BE-së, rregullat e reja do ta zvogëlojnë numrin e reagimeve negative. Megjithatë, ata që merren me tatuazhe janë ankuar se zëvendësimet nuk gjenden edhe aq lehtë, dhe kjo mund të ndikojë te kërkesat e konsumatorëve. Pas dy vjetëve të pandemisë, shumë biznese janë ankuar se nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme

për të bërë ndryshime.

"Koronavirusi, disa muaj të mbylljes, na kanë goditur keq. Tani kjo i vë kapakun", ka thënë artisti i tatuazheve në Hamburg, Sebastian Makowski. Bashkimi Evropian vlerëson se mbi 12 për qind e evropianëve kanë tatuazhe dhe kjo shifër mund të dyfishohet në mesin e të rinjve. Në Gjermani besohet se një në pesë persona ka tatuazhe, derisa në Belgjikë, qeveria beson se 500 000 tatuazhe të reja bëhen çdo vit.





## LDK-ja dhe PDK-ja arrijnë marrëveshje për bashkëqeverisje në Prishtinë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 JANAR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) kanë arritur të mërkurën marrëveshje për bashkëqeverisje në Prishtinë. PDK-ja me këtë marrëveshje do të ketë pesë drejtori dhe pozitën e nënkryetarit të komunës së Prishtinës.

Të mërkurën është zgjedhur edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal të Prishtinës. Në raundin e tretë të votimit

Fehmi Kupina nga LDK-ja është zgjedhur kryesues.

Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka deklaruar për medie pas raportimeve se LDK-ja dhe PDK-ja kanë arritur marrëveshje për të bashkëqeverisur në Prishtinë. Ai ka thënë se ende nuk i kanë ndarë pozitat me PDK-në. "Nuk i kemi ndarë postet me PDK-në. Kjo varet krejt prej njerëzve që na ofrojnë. Një gjë e mirë është se programi ynë ka qenë shumë i detajuar dhe kemi ngjashmëri të programit

me partitë e tjera dhe nuk do të kemi probleme", ka thënë ai. Rama u ka bërë thirrje edhe partive të tjera t'i bashkohen atij në bashkëqeverisje për zhvillimin e projekteve në kryeqytet. "Ne e kemi për detyrë të kemi shumicën që projektet tona t'i zbatojmë në përpikëri, prandaj të gjitha partitë që kanë interes duhet të na bashkohen. Tash e zgjedhëm kryesuesin dhe vazhdojmë me zgjedhjen e ekipit më të mirë", është shprehur kryetari i komunës së Prishtinës.



## Haradinaj: Majtizmi ekstrem po e dërgon Kurtin në luftë kundër aleatëve

Me besim  
në Zot  
në Atdhe  
në Shtet

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vazhduar kritikën në drejtim të qeverisë Kurti. Ai në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar për keqqeverisjen e Kurtit.

Haradinaj ka thënë se me këtë qeveri po ndodh mbushja shpejt e arkës dhe shterimi i burimeve, frikësimi i kapitalit vendor, nxjerrja jashtë e tij dhe, si rezultat i kësaj, po vjen deri tek ulja e investimeve.

Lideri i AAK-së ka theksuar se kjo qeveri ka krijuar armiqësi me sektorin privat dhe, sipas tij, qveria Kurti po bën luftë edhe ndaj UÇK-së. "Armiqësimi me sektorin privat dhe, si rrjedhojë, thellimi i mosbesimit të tyre dhe mospërkrahja nga ana e tyre e qëllimeve ekonomike. Lufta kundër UÇK-së, e zhvilluar si luftë ndaj pushtetit të keq të dy dekadave, e që si pasojë ka zbehjen e patriotizmit dhe të ndjenjave atdhetare për shtet", është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se kjo qeveri nuk i ka punët mirë as me politikën e

jashtme. "I frikësuar nga dialogu dhe i frikësuar nga Amerika. Në siguri dhe rend publik, improvizime dhe lëvizje eksperimentale, kryesisht populiste, përfshirë edhe luftën kundër krimi", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, po ndodh edhe politizim i iniciativave ligjore me agjendë partiake. "Mosimplementim i pavarësisë energjetike dhe faturim i energjisë në veri, si rezultat pagesa e dhjetëra milionave për rrymën e shpenzuar në veri. Refuzim dhe dëmtim i mundësive investive në energji, i projekteve si Kosova e Re, Contour Global 500 MW dhe

Gazsjellësi Amerikan me 200 milionë dollarë falas. Zhytja në korrupsion përmes tenderomanisë, pra tenderë njëburimor, dhënia e punëve punëdhënësve të mëhershëm, i pasuar me familjarizëm, pra punësime të familjarëve në poste kyçe, e pastaj politizim i bordeve të kompanive. E gjitha kjo në funksion të një lidhjeje të shkurtër për korrupsion dhe veprime joligjore, e që janë alarm për Kosovën", ka theksuar ish-kryeministri Haradinaj.

Ai e ka akuzuar qeverinë Kurti edhe për sulmet e ulëta nga militantët

imagjinare në internet që, sipas tij, janë të paguar me paratë e buxhetit të popullit dhe e tregojnë fytyrën e kësaj qeverie. "Të gjitha këto sulme vijnë si rrjedhojë e mungesës së vizionit dhe të pafuqisë me veprim qeverisës. Mosbuxhetimi dhe mosmiratimi i Ligjit të Pagave dhe lufta kundër sindikatave, po ashtu, është alarm në vete. Pra mund të themi që majtizmi ekstrem po e dërgon Kurtin dhe Vetëvendosjen drejt luftës së klasave dhe në luftë kundër aleatëve, që nënkupton po ia vështirëson Kosovës mundësinë e ecjes përpara", ka deklaruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

## Mehaj: Kushtet e shërbimit, rritja e pagave dhe mirëtrajtimi i FSK-së, objektiva për vitin 2022

PRISHTINË, 5 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka vizituar Regjimentin e Tretë të Këmbësorisë ku, bashkë me stafin komando-shtabor dhe ushtarakë të njësisë manovruese e mbështetëse, ndanë së

bashku përgëzimet për sukseset e mëdha të vitit që lamë pas. Ai ka thënë se Regjimenti i Tretë i Këmbësorisë është gjithmonë në krye të detyrave të mbrojtjes luftarake. "Kushtet e

shërbimit, rritja e pagave, mirëtrajtimi dhe mirëpajisja e pjesëtarëve të Regjimentit të Tretë dhe të gjitha njësisve të FSK-së janë ndër objektivat e mia kryesore për vitin 2022", ka thënë ministri Mehaj.







KËRKOHEM QË DIPLOMACIA E KOSOVËS TË KALOJË NË OFENSIVË PËR NJOHJE TË REJA

## Qeveria të angazhohet për njohjen edhe nga pesë vendet e BE-së

Njohësit e politikës së jashtme u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës që gjatë këtij viti të angazhohen për njohjet nga pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Edita Tahiri dhe Avdi Smajllaj kanë thënë për gazetën “Epoka e re” se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës duhet të krijojë strategji dhe grupe lobuese në kryeqendrat e Spanjës, Rumanisë, Sllovakisë, Qipros dhe Greqisë. Sipas tyre, gjatë këtyre muajve kjo ministri nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet në drejtim të fitimit të këtyre njohjeve

Kosovën”, ka thënë ajo. Sipas Tahirit, gjatë këtij viti Kosova duhet të hidhet në ofensivë diplomatike për t’i bindur këto vende. “Qeveria duhet të angazhohet për këtë punë. Të krijojë grupe strategjike lobuese në kryeqendrat e Spanjës, Rumanisë, Greqisë, Sllovakisë dhe Qipros. Nuk ka dëgjuar ndonjë lajm se Ministria e Jashtme është duke bërë ndonjë ofensivë diplomatike për fitimin e këtyre njohjeve. Natyrisht se për këtë çështje duhet kërkuar edhe përkrahjen e ShBA-së dhe të partnerëve tjerë të rëndësishëm në mënyrë që të vijjnë këto njohje”, është shprehur Tahiri.

Edhe politologu Avdi Smajllaj ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për qasjen ndaj pesë vendeve mosnjohje të BE-së. Sipas tij, MPJD-ja nuk ka strategji as për ta ndryshuar qasjen e vendeve skeptike të BE-së për liberalizim të vizave për Kosovën. “Në nivelin e integritit evropian Kosova ka vazhduar intensitetin e njëjtë për zbatimin e MSA-së, ndërsa nuk

ka pasur një strategji të qartë si të ndikojë te shtetet skeptike për çështjen e liberalizimit të vizave dhe as te shtetet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën”, është shprehur Smajllaj. Ai ka bërë me dije se qeveria duhet të hartojë një strategji për t’iu qasur shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. “Në nivelin global Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka treguar se ka kapacitete për ta avancuar interesin e Kosovës në nivel global. Nuk ka krijuar një strategji për t’iu qasur shteteve që janë kundër pavarësisë së Kosovës, shteteve skeptike, shteteve që e kanë njohur Kosovën, por nuk na mbështetin në politikën e jashtme dhe shteteve mbështetëse për t’i thelluar marrëdhëniet. Gjithashtu, jo vetëm që kanë munguar njohje, por nuk ka as edhe një strategji për këtë. E njëjta vlen edhe për anëtarësimin e Kosovës në mekanizma ndërkombëtarë”, ka deklaruar ai.

Gjatë vitit 2021 opozita dhe shoqëria civile e kanë kritikuar

politikën e jashtme të Kosovës, meqenëse gjatë këtij viti Kosova nuk ka marrë asnjë njohje dhe nuk është anëtarësuar në asnjë mekanizëm të rëndësishëm ndërkombëtar.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka mohuar kritikën në këtë fushë. Në adresimin e saj vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Osmani ka thënë se si udhëheqëse e politikës së jashtme është angazhuar për konsolidimin e shtetësisë dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. “Ne jemi të lumtur që mund të themi që Kosova është projekti më i rëndësishëm dhe më i suksesshëm i politikës së jashtme amerikane e evropiane, si dhe i të gjithë atyre që u rreshtuan pranë nesh. Prandaj, në vizitat e mia të realizuara këtë vit, përveç se kam shprehur mirënjohjen e palëkundur të qytetarëve tanë për aleancat që i kemi dhe për mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve tanë, jam përkushtuar për të ngritur nivelin

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Njohësit e politikës së jashtme i kanë ftuar institucionet e Kosovës që gjatë vitit 2022 të angazhohen më shumë për sigurimin e njohjeve nga pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin Republikën e Kosovës. Ata kanë bërë me dije për gazetën “Epoka e re” se Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës duhet ta bëjnë primar lobimin në Spanjë, Sllovaki, Rumani, Qipro dhe Greqi. Sipas tyre, duhet të

krijojnë grupe lobuese në kryeqendrat e këtyre vendeve. Ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, ka vlerësuar se deri më tani kjo ministri ka qenë në gjumë dimëror. “Kjo qeveri një prej pikave strategjike duhet ta ketë lobimin për njohjen nga këto pesë vende, mirëpo ajo që po shoh nga Ministria e Jashtme e Kosovës është se e tëra është në defanzivë. Kjo ministri është në një gjumë dimëror. Gjatë këtyre tetë muajve nuk kam parë ndonjë aktivitet lobues te këto pesë shtete që nuk e kanë njohur



## Hoti: Serbia po bën lojë me çështjen e të zhdukurve

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryetari i delegacionit të Kosovës për bisedime me Serbinë për çështjen e personave të zhdukur, Andin Hoti, ka kërkuar nga Bashkimi Evropian (BE) që të garantojë se çështja e personave të pagjetur të marrë epilog para marrëveshjes finale ndërmjet dy shteteve. Ai ka thënë se Serbia po bën lojë me këtë çështje duke mos ofruar informacione të sakta për mbi 1 600 persona të zhdukur.

Para fillimit të gërmimeve në lokacionet ku supozohet se ka varreza masive në Serbi, Hoti ka thënë se duhet të sigurohen imazhet satelitore. Në këtë kontekst, ai ka vlerësuar se nuk duhet të përsëritet ajo çfarë ka ndodhur në Rudnicë dhe Kizhevak të Serbisë. “2 700 gërmime janë bërë deri më sot

dhe janë 1 600 persona të zhdukur. Do të thotë, sfidë të madhe kemi mungesën e informacionit të saktë. Mungesën e informacionit të duhur se ku mund të janë këta persona të zhdukur. Nuk flas vetëm për varreza masive apo individuale, por edhe për informacione të personave të tjerë që jo medoemos i kanë vrarë në luftë, pra i kanë marrë të gjallë. Ne kemi dëshmi të shumta që shumë persona janë marrë të gjallë prej Kosovës dhe nuk dihet më fati i tyre çfarë ka ndodhur deri më sot”, ka thënë Hoti për “Kosovapress”.

Më tutje, Hoti, i cili kërkon informacion edhe për babanë e tij, Ukshinin, ka thënë se nuk mund të ketë normalizim të marrëdhënieve pa u ballafaquar Serbia me të kaluarën. Sipas tij,

adresa e vetme për këto krime është Beogradi, meqë shumë prej udhëheqësve gjatë kohës së luftës janë në pozita udhëheqëse edhe tani.

Hoti ka thënë se gjatë vitit të kaluar ka pasur mbi 100 takime me ndërkombëtarët për ta adresuar çështjen e personave të zhdukur. Në të gjitha ato takime ai ka thënë se ka kërkuar zbardhjen e fatit të personave të pagjetur dhe hapjen e të gjitha dokumentacioneve të luftës që ka Serbia. “Neve na duhet një presion më i madh dhe një bashkëpunim më i madh i faktorit ndërkombëtar. Ne nuk kemi mundësi dhe trysni për presionin ndaj Serbisë. Ne këtë gjë e dimë. Është faktori ndërkombëtar, Bashkimi Evropian, ShBA-ja, Britania e Madhe, që janë mike të Kosovës,

që duhet të kthejnë fokusin më shumë dhe ta rritin presionin më shumë me kushtëzim ndaj Serbisë, në mënyrë që kjo çështje të ketë epilog”, është shprehur Hoti.

Në marrëveshjen e veçantë për personat e zhdukur, Hoti ka thënë se Kosova nuk mund të jetë palë. “Përveç kërkesës për dokumentacione dhe arkiva të tyre, ne kemi kërkesë edhe ndaj Brukselit dhe Bashkimit Evropian që të jenë garantues. Ne e kemi provuar, janë 22 vjet, janë 16 vjet takime bilaterale me Serbinë dhe ne kemi provuar që ende janë 1 600 persona të zhdukur dhe po e shohim rezultat. Prandaj ne kërkojmë dhe është e nevojshme shumë që Brukseli të jetë garantues i takimeve tona me Serbinë. Brukseli duhet të garantojë për

ne që çështja e personave të zhdukur para marrëveshjes përfundimtare duhet të marrë një epilog”, ka thënë ai, duke shtuar se çështja e 300 mbetjeve mortore të pidentifikuara që ndodhen në morgun e Prishtinës duhet të marrë fund këtë vit.

Kryetari i delegacionit të Kosovës për bisedime për të zhdukurit, Andin Hoti, ka bërë me dije se gërmimet në Shtavall të Serbisë pritet të fillojnë së shpejti dhe se kanë informacione edhe për shumë varreza të tjera masive. Gjatë vitit të kaluar familjarëve u janë dorëzuar për varrim eshtrat e vetëm 25 personave. Në Kizhevak të Serbisë janë identifikuar mbetjet mortore të nëntë personave, shtatë të reja dhe dy ribashkim.



e shkëmbimit bilateral me vendet të cilat i kam vizituar, qoftë sa iu përket raporteve politike e diplomatike e deri tek ato të tregtisë, sigurisë, shëndetësisë, arsimit, turizmit, agjendës së gjelbër, teknologjisë informative e inovacionit, por edhe shumë fusha të tjera në interes të

qytetarëve tanë”, ka thënë Osmani.

Nga pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, Greqia ka pozicionin më liberal ndaj pavarësisë. Madje është aluduar se me ndërtimin e projektit për gazsjellësin të mbështetur nga MCC-ja, të cilin

qeveria e ka refuzuar, mund të vinte edhe njohja nga Greqia.

Gjithashtu, ky vend është shprehur pro liberalizmit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ndërsa më e rrepta kundër pavarësisë së Kosovës është shprehur Spanja, duke kundërshtuar në mënyrë kategorike pavarësinë e Kosovës.

Sipas shumë ekspertëve, njohja nga këto pesë vende varet nga dialogu për normalizim të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel i cili ka filluar në vitin 2011.

Deri më tani Kosovën e kanë njohur 117 shtete dhe njohja e fundit erdhi nga Izraeli në shkurt

të vitit 2021. Kjo njohje ka ardhur si rezultat i Marrëveshjes së Uashingtonit për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike në mes të Prishtinës dhe Beogradit që u nënshkrua më 4 shtator të vitit 2020 në Shtëpinë e Bardhë, në pani të ish-presidentit amerikan Donald Trump.



## Kryetari i Skenderajt cakton ditën e mërkurë takim me qytetarët

SKENDERAJ, 5 JANAR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka falënderuar qytetarët për vizitat e shumta dhe për urimet e tyre për

mandatin e ri qeverisës. Komuna e Skenderajt ka njoftuar se për shkak të angazhimeve të shumta në terren të kryetarit Nura, duke

filluar që nga java e ardhshme, takimet me qytetarë do të realizohen ditën e mërkurë, duke filluar nga ora 9:00-deri në orën

12:00. “Kryetari Nura ka falënderuar qytetarët për bashkëpunimin e tyre”, ka njoftuar komuna e Skenderajt.



## Nga e mërkura shërbimi mjekësor në shtëpi për qytetarët e Rahovecit

RAHOVEC, 5 JANAR - Nga dita e mërkurë në Rahovec do të funksionojë shërbimi i ri mjekësor “Kujdesi shtëpiak”, i cili do ta lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata me

sëmundje të rënda të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se një mjek dhe dy infermierë do të jenë në

lëvizje për të ofruar shërbime anembanë Rahovecit nga ora 07:00 deri në orën 21:00. “Përveç shërbimeve të tjera, ekipi mobil do të bëjë edhe testime rapide për Covid-19, sipas vlerësimit të mjekut. Jam

shumë i gëzuar që me nisjen e vitit të ri 2022 e nisëm edhe përmbushjen e premtimeve të fushatës së para pak muajve. Kujdesi shtëpiak, që nisi së ofruari sot, ishte njëri prej premtimeve tona në

programin qeverisës. Shpresoj që qytetarët e Rahovecit të kenë sa më pak nevojë për këtë shërbim dhe të kenë shëndet të mirë gjatë vitit që sapo ka nisur”, ka thënë kryetari Latifi.



## Hamza pret në takim drejtuesit e Shoqatës së Pensionistëve



MITROVICË, 5 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur të mërkurë në takim drejtuesit e Sindikatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në Mitrovicë, me të cilët ka biseduar për bashkëpunimin e

deritanishëm dhe për mundësitë e ofrimit të mbështetjes nga komuna e Mitrovicës. Në këtë takim Zymer Bajraktari, në emër të Shoqatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës në nivel të

Kosovës dhe Mitrovicës, i ka dhuruar mirënjohje kryetarit Bedri Hamza si shenjë falënderimi për bashkëpunimin e sinqertë si dhe për kontributin e dhënë për çështje të pensionistëve dhe invalidëve të punës.

## Shpërndahen 45 lopë qumështore për blegtorët llapjanë

PODUJEVË, 5 JANAR - Komuna e Podujevës, në partneritet me organizatën “OZHR Mëshqerra”, të mërkurë kanë shpërndarë 45 lopë qumështore të racës ‘Hollishtajn’ për blegtorët llapjanë. I pranishëm në ceremoninë e shpërndarjes ishte edhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, i cili premtoi mbështetje të

vazhdueshme për sektorin e blegtorisë në komunën e Podujevës. “Gjatë këtij viti, me buxhetin e Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), por edhe përmes bashkëpunimeve me partnerë të tjerë, siç është ky i sotmi, do t’u dalim në ndihmë fermerëve llapjanë”, ka thënë kryetari Bulliqi.



Kjo është hera e dytë që DBPZHR shpërndanë lopë qumështore të racës ‘Hollishtajn’ për blegtorët llapjanë, ndërsa ky projekt buron nga marrëveshja e bashkëpunimit në mes të komunës së Podujevës dhe “OZHR Mëshqerra” e nënshkruar vitin e kaluar.

## Sabri Kiçmari nis punën e ambasadorit të Kosovës në Japoni

PRISHTINË, 5 JANAR - Sabri Kiçmari ka arritur në Tokio të Japonisë për ta filluar punën e ambasadorit të

Kosovës në këtë shtet. I ngarkuari me punë në Ambasadën e Kosovës në Tokio, Arber Mehmeti, i ka

uruar mirëseardhje Kiçmarit në ambasadë. “Mirëseardhje dhe punë të mbarë ambasador prof. ass.

dr. Sabri Kiçmari”, ka shkruar Mehmeti në llogarinë e vet në “Facebook”.





## Opozita kërkon rritjen e pagës minimale, sindikata kërkon të mos jetë nën 400 euro

PRISHTINË, 5 JANAR - Paga minimale vazhdon të mos ndryshojë në Kosovë. Premtimet e ekzekutivit për ngritje të pagës minimale në 250 euro nuk u afrohen kërkesave të sindikatave që tashmë kërkojnë që të mos jetë nën 400 euro pas rrethanave të reja të krijuara. Opozita mendon se ngritja e pagës minimale është e domosdoshme për shkak të ngritjes së çmimeve, krizës energjetike dhe pandemisë. Paga minimale në Kosovë, ndonëse sipas Ligjit të Punës do të duhej të përcaktohej çdo vit, që nga viti 2011 vazhdon të jetë 130 euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç. Sipas nenit 57 të Ligjit të Punës, paga minimale duhet të përcaktohet duke marrë parasysh koston e shpenzimeve jetësore, përqindjen e shkallës së papunësisë, si dhe gjendjen e përgjithshme në tregun e punës dhe përcaktohet për periudhën njëvjeçare. Përkundër se vitin e kaluar

kërkuan që paga minimale të jetë 350 euro, kryetari i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat të Kosovës (SPSPK), Jusuf Azemi, ka thënë për "KosovaPress" se tashmë nuk duhet të ketë propozime nën 400 euro për pagë minimale pas rritjes së çmimeve dhe largimit të punëtorëve jashtë vendit. "Nëse kryeministri ose kushdo qoftë tjetër mendon se paga minimale do të jetë e arsyeshme me një pagë 250 ose 300 euro, po them kjo është një pagë e tejkaluar dhe ne nuk duam as të merremi me të", ka thënë Azemi. Kryetari i Komisionit Parlamentar për Ekonomi, njëherësh deputet i PDK-së në Kuvendin e Kosovës, Ferat Shala, ka thënë se inflacioni, kriza energjetike dhe situata me pandeminë e kanë bërë të detyrueshme rritjen e pagës minimale. "Nëse ndalem dhe i shikojmë rrjedhat dhe zhvillimet socio-ekonomike të vendit e sidomos në gjashtëmujorin fundit, është e domosdoshme ngritja e pagës minimale", ka thënë ai, duke shtuar se rritja e pagës minimale duhet të jetë



mbi 300 euro. "300 deri në 350 varësisht nga kalkulimet dhe llogaritjet që bëhen edhe në kuptimin buxhetor dhe financiar", ka potencuar Shala. Deputeti tjetër opozitar nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, pjesë e Komisionit për Buxhet, Pal Lekaj, ka thënë për "KosovaPress" se

qytetarët e kanë të vështirë jetesën në këtë kohë për shkak të rritjes së çmimeve prandaj, sipas tij, shfaqet nevoja edhe për rritje të pagës minimale deri në 350 euro. "Ne si AAK kemi menduar të bëhet nivelizimi i pagave. Paga minimale duhet të jetë së paku 350 euro, duke pasur parasysh ngritjen e çmimeve", ka thënë

Lekaj. Më herët kryeministri Kurti pati deklaruar se përmes rritjes së pagës minimale në 250 euro për 40 orë pune në javë dhe rritjes së pragut të pagës, që nuk tatóhet në nivelin e pagës minimale, ata të cilët kanë paga më të ulëta do të kenë më shumë para në xhep.

## Mediet botërore shkruajnë për ndalimin e prodhimit të kriptovalutave në Kosovë

PRISHTINË, 5 JANAR - Qeveria e Kosovës të martën ka ndaluar prodhimin e kriptomonedhave në një përpjekje për ta frenuar konsumin e energjisë elektrike, pasi vendi po përballet me krizën më të rëndë të energjisë në një dekadë për shkak të ndërprerjeve të prodhimit, shkruan "NYPost". "Të gjitha agjencitë ligjzbatuese do ta ndalojnë prodhimin e këtij aktiviteti në bashkëpunim me institucionet e tjera relevante që do t'i identifikojnë lokacionet ku ka prodhim të kriptovalutave", ka thënë në një deklaratë ministrja e Ekonomisë dhe Energjetikës, Artane Rizvanolli. Për shkak të çmimit të lirë të energjisë në Kosovë në vitet e fundit, shumë të rinj janë përfshirë në mihjen e monedhave të tilla si bitcoin.



Përballë ndërprerjeve të termocentraleve me qymyr dhe çmimeve të larta të importit, autoritetet u detyruan muajin e kaluar të prezantonin reduktimet e energjisë. Çmimet evropiane

të gazit u rritën me më shumë se 30 për qind të martën pasi furnizimet e ulëta nga Rusia rindezën shqetësimet për një krizë energjie, ndërsa moti më i ftohtë po afrohet. Në dhjetor Kosova shpalli

gjendjen e jashtëzakonshme për 60 ditë, e cila do t'i lejojë qeverisë të ndajë më shumë para për importet e energjisë, të prezantojë më shumë ndërprerje të energjisë dhe masa më të ashpra.

Një person, i cili foli në kushte anonimiteti dhe që ka 40 GPU (Njësitë e Përpunimit Grafik), i tha "Reuters"-it se ai po paguante rreth 170 euro në muaj për energjinë elektrike dhe po merr rreth 2 400 euro në muaj fitim nga minierat. Shfrytëzimi i monedhave ka qenë në rritje në veri të Kosovës, kryesisht të populluar nga serbë që nuk e njohin shtetin e Kosovës dhe refuzojnë të paguajnë energjinë elektrike. Vendi tani po importon më shumë se 40 për qind të energjisë së tij të konsumuar me kërkesa të larta gjatë dimrit, kur njerëzit përdorin energjinë elektrike kryesisht për ngrohje. Shifrat zyrtare tregojnë se Kosova ka rezervat e pesta më të mëdha të linjitet në botë prej 12-14 miliardë tonësh.

## Këmbimet valutore do të raportohen çdo ditë në Bankën e Shqipërisë

TIRANË, 5 JANAR - Që nga data 1 janar e këtij viti ka hyrë në fuqi një udhëzim i Bankës së Shqipërisë që i detyron të gjitha institucionet financiare të licencuara për veprimtarinë e kursit të këmbimit valutor të raportojnë veprime me bazë ditore. Subjekt i udhëzimit janë

bankat, pikat e këmbimit valutor dhe institucionet e tjera financiare të licencuara për këtë aktivitet. Bankat duhet të raportojnë me frekuencë ditore të gjitha veprimet e këmbimeve valutore të çdo monedhe të huaj kundrejt lekut, përfshirë veprimet me arin, brenda orës

17:00 të ditës në të cilën është lidhur marrëveshja, duke specifikuar monedhën e huaj, shumën dhe kursin e këmbimit. Veprimet e kryera pas kësaj ore dhe pozicioni valutor në çdo monedhë të huaj duhet të raportohen deri në orën 09:00 të ditës pasardhëse të punës.





# Pesë teoritë e reja konspirative, të cilat shkenca provoi se ishin të gabuara



Nga Ed Brown  
"Newsweek"

Teoritë e konspiracionit ekzistojnë prej dekadash. Disa kanë tendencën të rezistojnë (dhe zhvillohen) më shumë se të tjerat. Vitet e fundit, sidomos pas shfaqjes së pandemisë së Covid-19, janë shfaqur edhe teoritë të reja. "Newsweek" ka përpiluar një listë të teorive të reja konspirative, të cilat janë përgënjeshtruar nga argumentet shkencore.

## A e bëjnë magnetik trupin e njeriut vaksinat anti-Covid?

Një nga teoritë konspirative më të përhapura që nga fillimi i pandemisë, është se njëri nga efektet anësore të vaksinave kundër Covid-19 është magnetizimi i trupave të njerëzve. Ky dezinformim është përhapur pjesërisht nga videot në mediat sociale, ku disa njerëz që thoshin se ishin të vaksinuar, ngjshnin në krahë sende metalike si monedhat, duke pretenduar se këtë efekt e kishte shkaktuar vakcina.

Një version i teorisë pretendon se magnetizimi iu shtua vaksinave

në mënyrë që përbërësit e saj të lëvizin nëpër trup. Por kjo teori konspirative u kundërshtua gjerësisht. Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ekspertët në SHBA, deklaroi se vaksinat ndaj Covid-19 nuk përmbajnë metale apo ndonjë përbërës që do të prodhonte një fushë magnetike.

Dr. Karl Fihntenbaum, specialist i sëmundjeve infektive në Kolegjin e Mjekësisë të Universitetit të Sinsinatit, tha se nëse vaksinat do të kishin një efekt magnetizues, kjo do të ishte vënë re që në testet e hershme klinike.

## A e shkakton Covid-in rrjeti 5G?

Thelbi i kësaj teorie është se sinjalet e telefonisë celulare 5G të dërguara nga antenat përkatëse janë në fakt shkak i pandemisë aktuale. Sipas kësaj teorie antenat me valët 5G, mund të shkaktojnë Covid-19 duke shtypur sistemin imunitar ose duke e përhapur SARS-CoV-2 nëpërmjet valëve të radios.

Por sipas asaj që ka raportuar portali i njohur i kontrollit të fakteve "Full Fact", asnjë pretendim i tillë nuk mbështetet mbi prova, dhe se pandemia e koronavirusit po prek edhe

vendet që nuk kanë asnjë infrastrukturë të rrjetit 5G. Dr. Simon Klark, profesor i asociuar i mikrobiologjisë qelizore në Universitetin e Ridingut në Britani deklaroi në prill se kjo teori është një gënjeshtër e madhe.

Sipas tij sistemi imunitar i njerëzve mund të dëmtohet nga të gjitha llojet e gjërave, përfshirë të qenit i lodhur apo pa pasur një dietë të mirë ushqimore. Përveç kësaj, valët 5G renditen në fundin e spektrit elektromagnetik, dhe janë më pak të fuqishme sesa drita ose rrezet e diellit. Ato nuk janë aq të fortë sa të dëmtojnë qelizat.

## A shkaktojnë kancer parqet e gjeneratorëve që punojnë përmes erës?

Kjo teori është propaganduar pjesërisht edhe nga ish-presidenti amerikan Donald Trump. Duke folur në një tubim për mbledhjen e fondeve të fushatës në vitin 2019, ai u tha të pranishmëve: "Nëse keni një turbinë të erës diku afër shtëpisë tuaj, vlera e shtëpisë tuaj do bjerë automatikisht me 75 për qind. Dhe ata thonë se zhurma e tyre shkakton kancer".

Por po atë vit Shoqata Amerikane e Kancerit tha për "New York Times" se nuk ishte në dijeni të ndonjë prove të besueshme që lidh zhurmën e turbinave me kancerin. Efektet shëndetësore negative nga pajisje të tilla janë debatuar edhe me herët. Termi jozyrtar "Sindromi i Turbinës së Erës" i referohet simptomave si mungesa e gjumit dhe lodhja mendore për ata që jetojnë më pak se 2 kilometra larg turbinave të erës. Po kjo sindromë nuk njihet si një gjendje aktuale nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në SHBA.

## A po zhvillon Pentagoni një mikroçip që gjurmon Covid-in?

Në fillim të këtij viti u pretendua se Departamenti Amerikan i Mbrojtjes po prodhonte një çip që ndjen praninë e Covid-it dhe që mund të injektohej në trup. Këto pretendime lidheshin me komentet e bëra nga Met Hepbërn, një mjek ushtarak që ka punuar më herët për DARPA-n, Agjencinë Amerikane të Projekteve të Avancuara në Fushën e Mbrojtjes.

Por Hepbërn tha më pas për "Newsweek" se intervista e tij

ishite keqkuptuar dhe sipas tij nuk ka asnjë mikroçip apo gjëra të ngjashme. Sipas Hepbërn, teknologjia është në fakt një hidroxhel që rrit ndjeshmërinë ndaj laktatit të indeve nën lëkurë, gjë që mund të tregojë nëse dikush do të sëmurët.

## A jetuan njerëzit dikur në Mars dhe e shkatërruan atë?

Kjo teori u parashtrua nëpërmes një video të postuar të TikTok, e cila u pa nga qindra mijëra njerëz. Kjo teori pretendon se Marsi është i kuq për shkak të pluhurit nga shpërthimet bërthamore, dhe se ka prova që dikur në këtë planet ka pasur ujë, i cili është tharë nga njerëzit që kanë banuar dikur atje.

Por edhe kjo teori rrezohet për shkak të afateve kohore. Fosilet e njerëzve të hershëm në Afrikë datojnë nga 6 milionë deri në 2 milionë vjet më parë, ndërsa nga studimet rezultoi se Marsi ka pasur ujë miliarda vjet më parë. Për më tepër, Marsi është i kuq pasi sipërfaqja është e mbuluar me oksid hekuri, i njohur zakonisht si ndryshk, dhe jo me pluhur bërthamor. Bota.al.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

# Ballkani paraqet Ilir Dajën

Trajneri nga Shqipëria, Ilir Daja, është pasardhës i Bekim Isufit në pozitën e trajnerit të Ballkanit. Ish-trajneri i shumë skuadrave shqiptare do të kërkojë që ta fitojë titullin në BKT Superligën e Kosovës me skuadrën nga Suhareka, e cila në dy kampionatet e fundit dështoi të stoliset me titull kampion



## “Epoka e re”

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Skuadra e Ballkanit e ka paraqitur trajnerin e ri, Ilir Daja. Trajneri nga Shqipëria, në pozitën e shefit të shtabit teknik, e zëvendëson Bekim Isufin, i cili u shkarkua me arsyen e mospërmbushjes së synimeve të klubit. “Në ambientin e stadiumit të FC Ballkanit klubi ka arritur marrëveshje me trajnerin nga Shqipëria, Ilir Daja. Pas një mbledhjeje të stafit drejtues dhe stafit teknik, u vendos që Ilir Daja të marrë drejtimin e skuadrës, ndërkohë që Artim Pollozhani do të jetë ndihmës i tij. Kryetrajneri i ri i skuadrës sonë aventurën e fundit e kishte në Tiranë, ku drejtonte klubin e FK Partizani. Klubi i

dëshiron mirëseardhje trajnerit të ri në skuadër, duke i dëshiruar suksese dhe arritjen e qëllimeve të vendosura së bashku me skuadrën tonë”, thuhet në njoftimin e klubit nga Suhareka.

Ballkani sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e tretë me 33 pikë, dy pikë më pak se skuadra kryesuese Gjilani dhe një pikë më pak se skuadra e dytë në renditjen tabelore, Drita. Siç dihet, skuadra suharekase është duke e kërkuar që disa sezone titullin e kampionit, por ende nuk është duke e arritur një suksese të tillë edhe pse në dy kampionatet e fundit ka qenë një prej favoriteve kryesore. Në anën tjetër, emërimi i Dajës në krye të shtabit teknik mund të jetë një plus i madh për këtë klub, pasi trajneri 55-vjeçar nga Shqipëria ka një

përvojë të jashtëzakonshme, derisa ka drejtuar këto klube: Elbasani, Dinamo Tirana, Besa, Tirana, Skënderbeu, Flamurtari dhe Partizani.

## Dukagjini sot ‘ndez’ motorët për pranverë

Skuadra e Dukagjinit nga Klina, që bën gara në Superligë, stërvitet për sezonin pranveror do t’i fillojë sot (e enjte). “Klubi i Futbollit Dukagjini u rikthehet stërvitjeve. Ditën e enjte (06.01.2022), në stadiumin ‘18 Qershori’ Klinë, me fillim nga ora 11:00, fillojnë përgatitjet për sezonin pranveror. Na priftë e mbara!”, thuhet në njoftimin e Dukagjinit. Skuadra nga Klina sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e tetë me 18 pikë të grumbulluara.

## SHKURT

### Roma kërkon Vojvodën

Skuadra e Romës ka shfaqur interesim për mbrojtësin e Përfaqësueses së Kosovës, Mërgim Vojvoda, i cili aktualisht mbron ngjyrat e klubit tjetër italian, Torino. Sipas medieve italiane, kërkesë e trajnerit Jose Mourinho është transferimi i mbrojtësit “dardan” në afatin kalimtar të verës. Vojvoda ka shënuar një rritje të jashtëzakonshme në karrierën e tij pasi për pak vite ka arritur të jetë pjesë e një skuadre të madhe evropiane. Ai për Kosovën është paraqitur në 41 ndeshje dhe ka shënuar një gol.

### Muriqi gjithnjë e më larg Lazios, Sarri e dëshiron një 18-vjeçar

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, po kërkon të largohet nga Lazio, pasi nuk bën pjesë në planet e trajnerit Sarri. Klubi nga kryeqyteti italian ka arritur ta gjejë zëvendësuesin e tij. Bëhet fjalë për sulmuesin e Salzburgut, Benxhamin Sesko. Largimi i Muriqit do të ishte si bonus për të dyja palët. Sulmuesi 27-vjeçar kërkon minuta më shumë për të luajtur dhe ëndrra e tij është një rikthim te Fenerbahçe, por klubi turk duket se ende nuk ka asnjë plan për ta afruar lojtarin. Nga ana tjetër, Lazio do ta kishte më të lehtë të afronte Sesko nga Salzburgu, i cili shikohet si një talent që do ta ndihmojë ekipin e Sarrit në të ardhmen.

### Tri gjyqtare në futbollin shqiptar marrin stemën e FIFA-s

Një tjetër gjyqtare shqiptare merr stemën e FIFA-s. Bëhet fjalë për Mirela Çemerin, gjyqtare e kolegjiut të Durrësit, e cila është pajisur së fundmi me “pasaportën ndërkombëtare” e që i lejon tashmë të gjykojë ndeshje jo vetëm në Shqipëri, por edhe në arenën ndërkombëtare. Por Mirela Çemeri nuk është gjyqtarja e vetme që pajiset me stemën e FIFA-s, pasi edhe dy asistentet Mirjeta Salla dhe Edjena Kapxhiu, pas punës së palodhshme, u shpërblyen duke u pajisur me këtë aset të rëndësishëm. Kjo nuk është hera e parë që gjyqtare femra të rritura në mjedisin shqiptar arrijnë të pajisen me stema të FIFA-s, teksa më parë kanë arritur suksese të tilla edhe Emanuela Rusta si gjyqtare kryesore dhe Erinda Kume e Koleta Prenga si asistente.

## Përquku, asistuesja më e mirë në Superligën e Femrave

**PRISHTINË, 5 JANAR** - Një nga basketbollistet më të trofeshme në Kosovë është Arbnore Përquku. Ajo ka fituar trofe në Prishtinë, Penzë e Bashkim, kurse tani është rikthyer te prishtinaset, të cilat skuadra i ndihmoi të shpallen kampione vjeshtore me dhjetë fitore dhe pa asnjë humbje. Përveç lojës së mirë, Arbnorja njihet për

vizionin dhe asistimet e saj. Në Superligën e Femrave ishte asistuesja më e mirë me 7.4 për ndeshje. Pas saj ishte basketbollistja tjetër e Prishtinës, Aisia Robertson, me 6.8. Era Shatri e cila kaloi nga Prishtina në Bashkim ka 5.7 asistime për ndeshje, ndërsa ish-basketbollistja e Prishtinës, tash e Bashkimit, Irma Konjusha,

ndodhet në vendin e katërt me 5.3 asistime për ndeshje. Edhe tek asistimet nuk kishte si të mungonte Rael Whitsitt e Penzës me 5.2 asistime për ndeshje. Top pesë asistueset: Arbnore Përquku (Prishtina) 7.4, Aisia Robertson (Prishtina) 6.8, Era Shatri (Bashkimi) 5.7, Irma Konjusha (Bashkimi) 5.3, Rael Whitsitt (Penza) 5.2.



## 'El Clasico' për Haalandin

MADRID, 4 JANAR - Erling Haaland është një nga lojtarët që po përflitet shumë në këtë merkato. Zëra të shumtë e lidhin sulmuesin e Dortmundit me skuadrën e Real Madrid dhe, siç duket, e ardhmja e 24-vjeçarit qenka e lidhur

ngushtë me kampionatin spanjoll. Një nga golashënuesit më të mirë të futbollit evropian ka vënë në garë dy skuadra gjigante të La Ligës. Një "El Clasico" në mes të Real Madridit dhe Barcelonës do të shikojmë në këtë

merkato dhe "lufta" mes dy ekipeve për transferimin e sulmuesit norvegjez do të jetë e ashpër. Sipas "Marca", Barcelona ka nisur bisedimet me agjentin e lojtarit, Mino Raiola, për të transferuar Haaland në "Camp

Nou". Në këtë duel më i avantazhuar duket "Los Blankos" për shkak edhe të situatës ekonomike që ka për momentin, por gjithsesi Joan Laporta ka premtuar një goditje "big" për sulmin e skuadrës së Xavi



Hernandezit dhe Haaland mund të jetë lojtari "Big" i premtuar.

## Eriksen: Zemra ime s'është pengesë, dua të luaj në Botërorin 2022

KOPENHAGEN, 5 JANAR - Christian Eriksen e ka bërë të qartë qëllimin për t'u kthyer në futboll dhe dëshiron ta përfaqësojë Danimarkën në Kupën e Botës 2022 në Katar. Eriksen nuk ka luajtur futboll që prej se e pësoi një sulm kardiak gjatë një ndeshjeje në "Euro 2020" dhe, si pasojë, atij iu vendos një defibrilator në zemër. Mesfushori 29-vjeçar është lojtar i lirë tani, pasi e shkëputi marrëveshjen me Interin duke qenë se ligji italian nuk ia lejon të luajë në Serinë A me një aparat të tillë në zemër. Erikseni dëshiron ta fitojë kondicionin fizik përsëri dhe të jetë i gatshëm për t'ia dëshmuar trajnerit të ekipit kombëtar se ai mund ta përfaqësojë vendin e vet ende.



"Synimi im është të luaj në Kupën e Botës në Katar. Dua të duaj. Kjo ka qenë mendësia ime gjatë gjithë kohës. Është synim, ëndërr", ka thënë Eriksen. "Se a do të thirrem në kombëtare apo

jo është gjë tjetër, por është ëndërr e imja të rikthehem. Jam i sigurt se do të rikthehem sepse nuk ndihem ndryshe. Fizikisht jam përsëri në formë të lartë", ka shtuar Eriksen.

## Lakersat triumfojnë falë LeBronit, Phoenixi nuk i ndahet kreut në Perëndim

LOS ANXHELOS, 5 JANAR - Phoenixi fiton me rezultat 123-110 në fushën e New Orleansit dhe nuk i ndahet Golden States në betejën për kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit në NBA. Skuadra e Sunsit arriti një fitore të lehtë, ku u dallua Bookerit me 33 pikë. Vijon moment i mirë për Lakersat, që korrën suksesin e tretë radhazi, duke mposhtur



122-114 Sacramenton. Tjetër ndeshje e mirë për LeBron Jamesin, autor i 31 pikëve, mbështetur edhe nga Monk me 24 pikë. Në Lindje, skuadra e Torontos fitoi 129-104 ndaj

San Antonios, sfidë ku u dallua VanVleet me 33 pikë. Ndërsa Memphisi, falë 26 pikëve të Morantit, mundi 110-106 Clevelandin, duke arritur fitoren e gjashtë radhazi.

### REZULTATET

Cleveland - Memphis	106-110
Toronto - San Antonio	129-104
New York - Indiana	104-94
New Orleans - Phoenix	110-123
Lakers - Sacramento	122-114

### SHKURT

#### Messi shërohet nga Covidi, rikthehet në Paris

Lionel Messi është rikthyer në Paris, pasi u shërua plotësisht nga koronavirusi dhe pasi qëndroi shtatë ditë në izolim në Argentinë. Messi udhëtoi të mërkurën nga Rosario drejt kryeqytetit francez bashkë me bashkëshorten dhe tre djemtë, pasi doli negativ në testin për Covid-19. 34-vjeçari ishte një prej katër futbollistëve të Paris Saint-Germainit që dolën pozitivë në testin për Covid-19 në fundjavë. Ai qëndroi në izolim në Argentinë deri sot, kur edhe udhëtoi drejt Francës për t'u ribashkuar me ekipin e tij Paris Saint-Germain, që nënkupton se Messi mund të jetë i gatshëm për derbin kundër Lyonit të Xherdan Shaqirit të dielën që vjen.

#### 'El Clasico' luhet më 12 janar në Arabinë Saudite

"El Clasico" në mes të Real Madridit dhe Barcelonës do të luhet më 12 janar në ora 20:00. Ndërkaq, gjysmëfinalja tjetër e Kupës së Spanjës, në mes të Atletico Madridit dhe Atletico Bilbaos, do të luhet më 13 janar në orën 20:00. Finalja e madhe do të jetë të dielën, më 16 janar. "El Clasico" do të luhet në stadiumin "Rey Fahd". Ky njëherësh do të jetë përjetimi i parë i klasikes spanjolle për Xavi Hernandezin si trajner i Barcelonës.

#### Sainz: Në sezonin e ri, 7-8 pilotë në garë për titullin kampion

Rregullat e reja që do të aplikohen këtë vit në Formula 1 pritet të sjellin më shumë spektakël, parakalime dhe pilotë që do të shkojnë te fitorja. Këtë mendim ka spanjoli i Ferrarit, Carlos Sainz. Ai do të jetë në sezonin e tij të dytë me "kokëkuqen", ndërkohë që gjatë vitit të kaluar ai u paraqit mirë, duke mposhtur edhe shokun e tij të skuadrës Charles Leclerc. "Unë shpresoj që Mercedes e Red Bull të jenë përqendruar më shumë te gara për titull sesa te zhvillimi i makinës së re. Gjithsesi, mendoj se ato i kanë bërë paralelisht të dyja gjërat, ashtu sikurse kemi bërë edhe ne. Mendoj se sezoni i ri do të jetë i ekuilibruar, me 3-4 makina që mund të duelojnë për fitore. Ndaj do të kemi 7-8 pilotë të aftë ta fitojnë titullin", ka thënë Sainz.

#### Balotelli infektohet me Covid

Ish-sulmuesi i Kombëtares së Italisë, Mario Balotelli, është infektuar me Covid-19, gjatë pushimeve në Itali për Krishtlindje dhe Vitin e Ri. Klubi turk, Adana Demirsportit, ka bërë me dije se sulmuesi italian ka rezultuar pozitiv në testin për Covid. "Duke ndierë simptomat, futbollisti ynë Mario Balotelli ka rezultuar pozitiv në testin PCR për Covid-19, të cilin e ka kryer në vendin e tij, Itali. Lojtari ynë, i cili është izoluar menjëherë pas rezultatit të testit, këtë periudhë do ta kalojë në shtëpi në Itali. I urojmë lojtarit tonë shërim të shpejtë", thuhet në njoftimin e Adana Demirsportit.

## Superkompjuteri parashikon Premierë Ligën, City shpallet kampion

Sipas parashikimeve të Superkompjuterit, titulli i kampionit në Premierligë duket tashmë punë e kryer. Skuadra e Manchester Cityt shihet si favorit për të triumfuar në fund, pas

distancës së krijuar në fillim të janarit. Pjesa interesante e parashikimit lidhet me top katërshen, ku gjithçka është në pikëpyetje aktualisht. Manchester Unitedi, përveç që mbetet jashtë top

katërshes, parashikohet të përfundojë në pozitën e gjashtë. Arsenali kompletton katërshen me Cityn në pozitën e parë, Liverpooli në të dytën dhe Chelsea në të tretën. Ndërkohë

Tottenhami parashihet të jetë skuadra e pestë. Në pjesën e poshtë të renditjes, Norwichi pritet të jetë skuadra që bie nga liga, së bashku me Newcastlein dhe Watfordin.





**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se “Koca Law Office” L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr: 811861097 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavje se svi klienti da drustvo sa “Koca Law Office” L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr: 811861097 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “Koca Law Office” L.L.C. Pristine. has come to the decision to quit its business: 811861097 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Besarta Bardoniqi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

► Elizabeta Sabri Islami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme Ekonomike drejtimi Juridik Prishtinë.

► Liridon Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl II dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Votin Kolukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.

► Dyze Daqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Shtjefen Gjeqovi" Zym.

► Ilami Susuri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Mert Artan shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Emin Duraku" Prizren.

► Arian Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

► Uran Shala shpall te pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

